



REPUBLIKA E SHQIPERISE KESHILLI I BASHKISE LEZHE

Bashkia, Lagja "Skënderbeu", Rruga Frang Bardhi, Lezhë – ALBANIA tel/fax: 00 355 215 2270/2570 email : mayor@lezha.gov.al

V E N D I M

Nr. 2, Datë 04/02/2014

(ndryshuar me VKB nr.1 date 15.01.2015)

PER

MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE

Mbështetur në :

- Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", Ligji nr. 9745, datë 28.05.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" , Ligji nr. 9764, datë 09.07.2007 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", Ligji nr. 9931. date 09.06.2008 "Për disa ndryshime në ligjin nr .9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", Ligji nr. 10073, datë 09.02.2009 Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", Ligji nr. 10117, datë 23.04.2009, "Për disa ndryshime në ligjin nr.9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar", Ligji nr. 10146, datë 28.9.2009, "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar", Ligji nr. 10354, datë 18.11.2010, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, Ligji nr. 10457, datë 21.07.2011 Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore".
- Ligji nr.9161, datë 18.12.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat " i ndryshuar, Ligji nr.9326, datë 6.12.2004 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar"
- Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"i ndryshuar".
- Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji nr.10280, datë 20.5.2010, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar", Ligj nr.10458, datë 21.7.2011, "Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, date 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar". ligji 180/2013 " Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.9632 date 30.10.2006"Per sistemin e taksave vendore"

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 1.8.2007 “Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”
- Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011, “Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”
- Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm) Nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore “
- Udhëzim i Ministrisë të Financave Nr.1, datë 12.1.2007 “Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”
- Udhëzimi i Ministrisë të Financave, nr. 18, datë 23.08.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.26, datë 04.09.2008 “Për taksat kombëtare” të ndryshuar”
- Udhëzim i MF nr. 32, datë 31.12. 2013 Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël

Këshilli i Bashkisë Lezhë, pas shqyrtimit të materialit të paraqitur nga Kryetari Bashkisë Lezhë, dhe pas diskutimit të antarëve ;

V E N D O S I

- 1. Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat përgjegjëse për vjeljen e tyre si dhe nivelin e gjobave për kundravajtjet, si më poshtë vijon :**

NENI 1

Kapitulli I: Taksat vendore

Taksat vendore trajtohen në mënyrë nominale duke u nisur nga këto elementë:

- Llojit, baza e taksueshem, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

I.1 Taksa mbi pasurite e paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë të pasurive në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe.

Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron.

Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë. Taksa mbi mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga:

- II.1.1 Taksa mbi ndërtesën;
- II.1.2 Taksa mbi tokën bujqësore.

I.1.1 Taksa mbi ndërtesën;

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi.

Kategoritë dhe nënkategoritë. nivelet treguese të taksës mbi ndërtesën prezantohen si më poshtë vijon.

Kategoritë dhe nënkategoritë	Lekë/m²/vit
Kategoria I. NDËRTESA BANIMI	
<i>Ndërtuar para 1993 – shit</i>	
Ndërtesa banimi	10
<i>Ndërtua pas 1993 – shit</i>	
Ndërtesa banimi	12
Kategoria II. NDËRTESA TË TJERA	
<i>Ndërtesa për tregti dhe shërbime</i>	
<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtesa për shërbime shëndetsore, artizanale, social kulturore, arsimore e shkencore. - Ndërtesa për shërbime tregtare, administrative etj - Të tjera 	240
<i>Të tjera</i>	
<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtesa prodhimi. - Ndërtesat në pronësi të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve - Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit kur janë objekte të ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-ndërmarrjeve shtetërore të privatizuara ku nuk zhvillohet aktivitet. 	60
Kategoria III	
<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike. 	400

Tatimpaguesit që kanë në pronësi më shumë se një banesë, për shtëpinë ku kanë banimin e zakonshëm paguajnë taksën e ndërtesës, sipas kesaj pasqyre, ndërsa për të gjitha shtëpitë e tjera, taksa e ndërtesës është sa dyfishi i taksës së ndërtesës, që zbatohet në zonën ku ndodhet kjo ndërtesë

Kategoria I. NDËRTESA BANIMI

Përfshihen: Të gjitha hapsirat që përdoren për qëllim jo fitimprurës nga qytetarët vetëm për qëllim banim.

Kategoria II. NDËRTESA TË TJERA

Përfshihen:

Nënkategoria ndërtesa për tregti dhe shërbime

- *Ndërtesa për shërbime shëndetsore, artizanale, social kulturore, arsimore e shkencore.* Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat (farmaci, klinika, spitale, maternitete, qendra shëndetësore të të gjitha specialiteteve dhe njësitë e shërbimit artizanal si marangoz, këpucar, orëndreqës, etj të ngjashme me to). Shkollat, kopshtet, cerdhe, qendra kulturore, qendra sociale, stadione, komplekse sportive si palestra, fitnes, pishina të hapura e të mbyllura, ndërtesa shkencore si institute kërkimore, qendra kërkimore, interneti, sallat e koncerteve, videoteka etj.
- *Ndërtesa për shërbime tregtare, administrative etj të ngjashme me to:* Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat, hotele, motele, stabiliment turistike, shtëpi pritje, turizëm familje, qendra biznesi, pika karburanti, magazina, depo, bankat, zyrat, njësi tregtare dhe shërbimi të cdo lloji etj të ngjashme me to.
- *Ndërtesa të tjera.* Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat të cilat nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme.

Nënkategoria Të tjera

- *Ndërtesa të tjera*
- *Ndërtesa prodhimi.* Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat në të cilat ushtrohet aktivitet prodhues si përpunim duralumini, metalesh, druri, tapecierie, letre, kartoni, plasmasi, tulla, tjegulla, blloqe banimi, furra gëlqereje, prodhime ushqimore, prodhim konfeksionesh, prodhim dhe përpunim vajrash, naftë etj, shtypshkronja, prodhim dhe përpunim produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to.

Ndërtesat në pronësi të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve; Do të përfshihen pronat të cilat përdoren nga organizatat jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, zyrat e përfaqësimit të organizmave ndërkombëtare, ambasadat të njohura ose të rregjistruara si të tilla në gjykatë.

Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit kur janë objekte të ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-ndërmarrjeve shtetërore të privatizuara ku nuk zhvillohet aktivitet. Do të kuptojmë të gjithë objektet të cilat janë kapital i Ndërmarrjeve shtetërore dhe kanë qënë kapital i ish-ndërmarrjeve shtetëror:

- Kur është objekt i ndërmarrjeve shtetërore ekzistuese të cilat janë tërësisht të amortizuara (vlera e amortizimit mbi 80 % e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pamvarësisht nga vlera e amortizimit. Për këto 2 lloj objektesh duhet të plotësohet kushti që ato janë jashtë funksionit dhe në to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.
- Kur ka qënë objekt i ish- ndërmarrjeve shtetërore të cilat janë privatizuar (tërësisht ose pjesërisht Ndërmarrja ose vetë objekti) dhe është tërësisht i amortizuara (vlera e amortizimit mbi 80 % e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pamvarësisht nga vlera e amortizimit. Për këto 2

Iloj objektesh duhet të plotësohet kushti që ato janë jashtë funksionit dhe në to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.

Për ato kategori ndërtesash banimi të cilat janë të rregjistruara si seli të subjekteve tregtare, taksa e pasurisë përlllogaritet dhe paguhet si Kategoria II, ndërtesa të tjera sipas rastit të ushtrimit të veprimtarisë duke u përjashtuar nga Kategoria e I-rë, Ndërtesa Banimi.

Kategoria III, FSHATRA TURISTIKE

Përfshihen të gjithë taksapaguesit, të cilët kanë, në përdorim apo në pronësi, ndërtesa brenda territoreve të miratuara si fshatra turistike.

Mënyra e pagesës:

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim **paguhet me nje kest**. Afati i pagesës është data 20 Prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Cdo posedues pasurie duhet të paraqesë dokumentin e pronësisë mbi pasurinë që zotëron, në të kundërt pagesa do kryhet duke marrë për bazë sipërfaqen prej 100 m² për cdo rast.

Përjashtime:

Përjashtohen nga pagesa e taksës:

- Pronat e shtetit dhe të njesive të qeverisjes vendore që përdoren për qëllime jofitimpruese, ndërtesat e banimit që shfrytësohen nga qirramaresit me qera të paliberalizuara,
- ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare.
- pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore.
- Familjet që kanë k/familjarin invalidë të punës, invalidë të luftës;
- Familjet e veteraneve të luftës: familjet e deshmorëve të Atdheut
- Familjet që kanë në perberjen e tyre të verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si individë;
- Familjet që janë perfituese të ndihmës ekonomike;
- Pensionistët e vetëm ose me persona madhore të papunë

Për të përfituar nga përjashtimi, këto familje duhet të dorëzojnë në drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë dokumentat e mëposhtëm.

- Librezën përkatëse;
- Vërtetimin e papunësisë nga zyra e punës
- Vërtetimin e përfitimit të ndihmës ekonomike
-

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës ;

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat për të gjitha kategoritë është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë.

I.1.2 Taksa mbi tokën bujqësore.

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë.

Taksa mbi tokën bujqësore është një detyrim vjetor. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Kategorite e tokes bujqesore	Lekë/ ha / vit
I	5 600
II	4 900
III	4 200
IV	3 600
V	3 000
VI	2 400
VII – X	1 800

Mënyra e pagesës:

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim **paguhet me nje kest**. Afati i pagesës është data 20 Prill.

Për pronat e njohura nga komisioni i kthimit pronave sqarojmë se: për personat që i zoterojnë këto prona aplikohet taksa sipas natyres së pronës, nëse është tokë bujqësore, trajtohen si të tilla nëse janë pyje ose inproduktive sipas ligjeve në fuqi.

Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, **formulari 6, akti I** pronësisë, certifikatë e regjistrimit të tokës.

Përrjashtime:

Përrjashtohen nga taksa e tokës bujqësore, vetëm për normën individuale të tokës, individët:

- Invalidët e punës e të luftës; veteranet
- Të verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si individë;

Përrjashtohen nga taksa mbi tokën bujqësore familjet;

- Që janë perfituese të ndihmës ekonomike;
- Pencionistet e vetem
- Tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes

Për të përfituar nga përrjashtimi, këto familje duhet të dorëzojnë në drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë dokumentat dokumentat e mëposhtëm.

- Librezën përkatëse;
- Vërtetimin e përfitimit të ndihmës ekonomike;
- Vendimin e këshillit Bashkisë.

Strukturat përrgjegjëse për vjeljet e taksës ;

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore për të gjitha kategoritë është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë.

Ngarkonet Zyra e menaxhimit të tokës pranë Bashkisë Lezhë për përcaktimin e sipërfaqes në pronesi sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme.

1.2 Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet, gjatë vitit fiskal, një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) më e vogël ose e barabartë me 8.000.000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së **tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël**

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë, është 7,5 për qind dhe për subjektet me qarkullim vjetor nga 0 deri në 2 milionë lekë, është 25 000 lekë në vit.

Mënyra e pagesës:

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, për subjektet me qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 Dhjetor te cdo viti.

Tatimpaguesit me qarkullim nga 0 deri në 2 milionë lekë në vit paguajnë tatimin fiks, në masën 25 000 lekë në vit, brenda gjashtëmujorit të parë të çdo viti,

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Agjent tatimor për vjeljen e tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël është Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë.

I.3 Taksa e fjetjes në hotel

Baza e taksës së fjetjes në hotel, është çmimi i fjetjes, për dhomë ose për person, për një natë me koeficient shtrytezimi 250 dite në vit. Janë subjekt i taksës të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie.

Niveli i taksës jepet si më poshtë:

Taksa e fjetjes në hotel	
Niveli	3.5

Mënyra e pagesës:

Pagesa kryhet brenda datës 5 të muajit pasardhës. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të Bashkisë dhe evidentohet në faturën e hotelit ku shënohet çmimi i fjetjes dhe vlera e taksës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës së fjetjes në hotel

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë.

I.4 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit. Detyrimi për taksën i takon investitorit.

Niveli i taksës sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve, është si më poshtë:

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË	%
Objekte banimi, administrative, shërbimi etj.	3
Objekte banimi, administrative, shërbimi etj me mbi 2 kate parkim nëntokë	2
Objekte për qëllime publike kopshte, çerdhe, shkolla, spitale	2

(private dhe shtetërore)	
Infrastrukturë (private dhe shtetërore) si : rrugë, ujësjellës, kanalizime, ndriçim publik, telefoni etj.	2
Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi	0.5

Mënyra e pagesës:

Përlllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet, duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorisë dhe nënkategorisë, ndaj vlerës së investimit për sipërfaqe respektive.

Në rastet kur një ndërtesë ka funksione të përziera (banim dhe administrative etj,përlllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet, duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorisë dhe nënkategorisë, ndaj vlerës së investimit për sipërfaqe respektive të pjesës së banimit dhe atë administrative, shërbimi etj.

Lehtësirat tatimore

Përrjashtimisht për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar.

Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës ;

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë.

Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Urbanistikës pranë Bashkisë Lezhë.

1.5 Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme aplikohet për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Mënyra e pagesës:

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lek/m² të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Përrjashtimet

Neni 29 i ligjit 9632 datë 30.10.2006 jep të gjitha rastet e përjashtimit nga pagesa e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:

Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme e cila në rolin e agentit të taksës përfitonë 3 % të shumës së arkëtuar, diferenca kalon për llogari të buxhetit vendor jo më vonë se datë 30 e muajit pasardhës.

Ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Lezhë të beje rakordimet me ZRPP Lezhë dhe planifikimin e të ardhurave.

I.6 Taksa për zënie e hapësirave publike

Baza e taksës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m², e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi e dhene me kontratë nga Bashkia për ushtrim aktiviteti biznesi. Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit.

Kategoritë dhe nënkategoritë e taksës për zënie e hapësirave publike sipas zonave të banimit jepen si në tabelën e mëposhtme:

KATEGORIA DHE NËNKATEGORITË		NIVELI TREGUES I TAKSËS/MUAJ
	Zënie e hapësirës publike (përdorim trualli)/ nënkategoritë	lekë/m²
A	Organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme	99
B	Zënia e Hapësirës publike për qëllime biznesi/tregtimi në Tregjet Publike të administruara nga Bashkia Lezhë;	
	<i>b.1 Artikuj industrial</i>	99
	<i>b.2 Artikuj të ndryshëm dhe ushqimor</i>	99
C	Zënia e hapësirës publike për qëllime biznesi si: vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, vendosje tavolinash sipërfaqet e zëna me platforma , sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to, sipërfaqe të zëna me antena televizive dhe telefoni, gabina elektrike, nënëstacione, fusha sportive, varreza makinash, pishina etj të kësaj natyre, cadra fushimi, rulota etj të ngjashme me to.	99

Mënyrat e pagesës:

Detyrimi i taksës përlllogaritet si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelet treguese të saj.

- Pika a) Për rastin e përdorimit të truallit me qëllim organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme pagesa do të bëhet me marrjen e Lejes për Ushtrimin e Aktivitetit e cila do të jepet nga Sektori i dhënies së lejeve pranë Bashkisë Lezhë. Është ky sektor i cili kryen dhe llogaritjen e detyrimit për lejen përkatëse.
- Pika b) Për rastin e përdorimit të truallit me qëllim ushtrimin e aktivitetit tregtar në Tregjet Publike që administrohen nga Bashkia Lezhë detyrimi është mujor dhe pagesa do të bëhet brenda datës 30 të muajit përkatës pranë Bashkisë.
- Pika c) Për rastin e përdorimit të truallit qëllim ushtrim aktiviteti tregtar si vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, sipërfaqet e zëna me platforma , sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj, detyrimi është mujor dhe pagesa do të bëhet brenda datës 30 të muajit përkatës pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave, Bashkisë Lezhë.

Lehtësirat tatimore

Taksapaguesit përfitojnë kushte lehtësuese kur:

- Lidhin kontratë për zënie të hapësirës publike me afat 6-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 5% të vlerës së detyrimit.
- Lidhin kontratë për zënie të hapësirës publike me afat 12-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 10% të vlerës së detyrimit.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës ;

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë.

Zyra e urbanistikës ngarkohet për hartimin e dokumentacionit dhe përcaktimin e sipërfaqeve/hartave të parcelave objekt i kësaj takse si dhe publikimin e tyre.

Zyra juridike ngarkohet për përgatitjen e kontratës tip për dhenien e siperfaqeve me qera.

I.7 Taksa e tableles

Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet të cilët vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime reklamimi.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve dhe subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e transportit **dhe profesioneve të lira**.

Kategoritë dhe niveli i taksës jepet si në tabelën e mëposhtme .

Kategoritë	Niveli
I. Tabelë për qëllime identifikimi: a) Tabelë për qëllime identifikimi, pavarësisht nga sipërfaqja, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. b) Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim.	120 lekë/vit
II. Tabelë për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike:	
a) Deri në sipërfaqen 18 m ² .	22500 lekë/m ² /vit
b) Për sipërfaqe më të mëdha se 18 m ²	405000 lekë/vit
III. Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.	1000 lekë/m ² /ditë

Në kategorinë I: Vendosje table për qëllime identifikimi, kuptojmë të gjithë tabelat të vendosura në pamjet ballore të njësisë ku ushtrohet aktivitet, duke qenë pjesë përbërëse e saj ku evidentohet emri dhe lloji i veprimtarisë së vetë subjektit.

Në kategorinë II: Vendosje table për qëllime reklamimi (të lëvizshme dhe të palëvizshme) kuptojmë të gjithë tabelat të vendosura në pamje jo ballore, të vendosura në tarraca, llozhe, ballkone, në pjesë të rrugës, shtylla etj që kanë përmbajtje me qëllime reklamimi për vete ose të tretë.

Në këtë kategori përfshihen:

- Të gjitha reklamat statike, ndiçuese ose jo ndiçuese, faqet murale dhe autolëvizëse dhe të gjitha reklamat e lëvizshme me fletë, pamje dy ose tre vizionëshe, elektromekanike ose pa ndriçim, faqet murale dhe autolëvizëse
- Tabelat elektronike (të lëvizshme dhe të palëvizshme) për qëllime reklamimi: do të kuptojmë reklamat digitale, lineare me të gjitha elementët gjysëm përçues etj.

Në kategorinë III: Vendosje table në funksion apo ekspozime të ndryshme të hapura do të kuptojmë të gjithë ato tabela në funksion te panaireve të ndryshme etj. që kanë si qëllim reklamimi për vete ose për të tretët.

Mënyra e pagesës

Detyrimi për Taksën e Tabelës për **Kategorinë I dhe II** është vjetor.

- **Për kategorinë I** detyrimi paguhet brenda datës 20 Prill të vitit fiskal. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet që nga muaji korrent që subjekti regjistrohet pranë QKR. Taksa e tabelës për qëllime identifikimi paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin nga muaji korrent që regjistrohet pranë QKR. Në rastin e më shumë se një table, pavarësisht nga vendndodhja, vetëm njëra do të konsiderohet si tabelë me qëllime identifikuese ndërsa tabelat e tjera do të konsiderohen si tabela me qëllime reklamuese
- **Për kategorinë II** detyrimi paguhet brenda datës 20 Prill të vitit fiskal. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i montimit të tabelës me qëllim reklamues. Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal).
- **Për kategorinë III** detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të Bashkisë Lezhë

Lehtësirat tatimore

Për kategorinë II taksapaguesit përfitojnë kushte lehtësuese kur:

- Lidhin kontratë me afat 6-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 5% të vlerës së detyrimit.
- Lidhin kontratë me afat 12-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 10% të vlerës së detyrimit.

Përfshirje

Nga pagesa e taksës së tabelës për **kategorinë I** përjashtohen subjektet Ambulant të cilët nuk kanë një vendndodhje fikse biznesi, **dhe profesionet e lira.**

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës ;

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë.

Per Kategorinë II. Tabelë për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike: Zyra e urbanistikës ngarkohet për hartimin e dokumentacionit të plotë të marrjes së lejes për vendosjen e reklamave dhe përcaktimin e sipërfaqeve objekt taksimi. Kjo zyrë njofton në mënyrë periodike Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore në lidhje me të gjitha ndryshimet në sipërfaqe (shtesa apo pakësime) që janë objekt i kësaj takse.

Për të gjitha kategoritë, Zyra juridike ngarkohet për përgatitjen e kontratës tip me qëllim aplikimin e lehtësive tatimore.

1.8. Taksa e perkohshme per infrastrukture nentoksore (telefoni, energji, tv kabllor,gaz, ujselles)

Baza e taksës është gjatësia dhe gjerësia në m² e infrastruktures nentoksore, e cila vihet në shfrytëzim nga subjektet për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit duke shumezuar bazën e taksës me gjatësin* gjerësinë e infrastruktures nentoksore. Niveli i kësaj takse është 700 leke/m².

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës;

Struktura e ngarkuar për vjeljen e **Taksa e perkohshme per infrastrukture nentoksore** është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë
Afati i pagesës data 20 Prille.

NENI 2

Kapitulli II: Tarifat vendore

Ky kapitull trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Llojit, baza e taksueshem, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

2.1 Tarifa e shërbimeve publike (pastrimit dhe largimit të mbeturinave, gjelbërimit, ndriçimit dhe dekorit)

Tarifës së shërbimeve publike i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Lezhë.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së Shërbimeve janë të shprehura si në Aneksin Nr.2.

Mënyra e pagesës

Detyrimi për Tarifën e Shërbimeve është vjetor.

Kategoria I “Familjarët”: Detyrimi paguhet brenda datës 20 Prill. Për çdo familje të krijuar rishtaz, afati i pagesës së tarifës së shërbimeve publike do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjëndjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj.

Detyrimi llogaritet dhe paguhet për familje. Për të llogaritur detyrimin për tarifën kjo kategori duhet të paraqesë pranë strukture së taksave të Bashkisë çertifikatën e gjendjes familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile.

Kategoria II. "Biznesi": Detyrimi paguhet brenda datë 20 Prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit prane QKR.

Për kategorinë **II.4 "Subjekte Ndërtimi"** nënkategorinë "Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, etj të ngjashëm me to "Rikonstruksione të pjesshme për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla kopshte, objekte banimi e tregtare, etj të ngjashëm me to", llogaritja e taksës bëhet për periudhën nga momenti i ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë strukturave të Bashkisë Lezhë të kërkesës për leje shfrytëzimi. Këtu përjashtohen kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga buxheti i Bashkisë apo buxheti i shtetit.

Për të gjitha kategoritë:

Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal).

Përjashtime:

Përjashtohen nga pagesa e tarifës së shërbimeve:

- Familjet që kanë k/familjarin invalidë të punës, invalidë të luftës;
- Familjet e veteraneve të luftës: familjet e deshmorëve të Atdheut
- Familjet që kanë në perberjen e tyre të verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si individë;
- Familjet që janë perfituese të ndihmës ekonomike;
- Pensionistet e vetëm ose me persona madhore të papunë

Për të përfituar nga përjashtimi, këto familje duhet të dorëzojnë në drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë dokumentat e mëposhtëm.

- Librezën përkatëse;
- Vërtetimin e papunësisë nga zyra e punës
- Vërtetimin e përfitimit të ndihmës ekonomike

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës;

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së shërbimeve publike është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë

2.2 Tarifa e parkimit të automjeteve

Tarifa për parkimin e automjeteve në vendparkime publike me pagesë dhe tarifa për vendqëndrime të mjeteve të liçensuara taksi, për një orë caktohet :

Kategoritë	Tarifa për parkim në vëndet e miratuara publike (blu)	Tarifa për parkim të rezervuar/stacione (verdhë në vit)
Autobusa të të gjitha llojeve	100 lekë/orë	25000
Autoveturat Shtetërore dhe private	50 lekë/orë	25000
Taksi 4 + 1 dhe 8+1	20 lekë/orë	8,000/10,000
Automjete të transportit të përzier deri 3.5 tonë	50 lekë/orë	

Subjektet e biznesit të vogël mund të marrin leje parkimi vetëm për një vendparkim, ndërsa subjektet e biznesit të madh 2 vende parkimi.

Mënyra e pagesës

Të gjithë subjektet që përfitojnë nga rezervimi i vend parkimeve të miratuara janë të detyruar të lidhin kontratë me Drejtorinë Juridike pranë Bashkisë Lezhë, pasi subjekti ka marrë lejen përkatëse nga strukturat e transportit pranë Bashkisë .

Lehtësirat tatimore

Përfitojnë kushte lehtësuese kur:

- Lidhin kontratë me afat 6-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 5% të vlerës së detyrimit.
- Lidhin kontratë me afat 12-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 10% të vlerës së detyrimit.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës;

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së parkimit është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë

Drejtoria e Shërbimeve është përgjegjëse për dhenien e lejes së parkimit te rezervuar.

Drejtoria juridike harton kontratën tip për parkimet e rezervuara.

2.3 Tarifa vjetore e mjeteve të përdorura.

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është e vlefshme për 365 ditë dhe caktohet sipas formulës: Cilindrata në cm³ x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit dhe ka zëvendësuar Taksën e rregjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor.

Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblihet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës;

Agjenti tatimor për vjeljen e taksës vjetore për mjetet e përdorura është Drejtoria Rrugore e Transportit, e cila i kalon 18 % e vlerës së grumbulluar njesise vendore, për mjetet që janë në territorin e saj.

Rakordimi pagesës së taksës midis DPSHTRR dhe Zyrës së të Ardhurave kryhet në bazë të regjistrimit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura sipas formatit të përcaktuar në Udhëzim. Procedura e ndarjes së të ardhurave në buxhetin vendor përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

2.4 Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë lezhë

2.4.1 Tarifa të urbanistikës

Grupi i tarifave të mëposhtëme aplikohet për shërbimet që banorët/subjektet marrin nga Bashkia për çështje që lidhen me zhvillimin urbanistik.

Nr	Llojet e tarifave	Njesia e matjes	Tarifa
1	Pranim dosje për shqyrtim për të gjitha		

	Ilojet e aplikimeve.		
	<i>Per nevoja biznesi</i>	Lekë/dosje	5.000
	<i>Per shtepi banimi</i>	Lekë/dosje	2.000
	<i>Për ndryshim destinacioni</i>	Lekë/dosje	2.000
2	Njehsim i dokumenteve me origjinalin	Lekë/dokument	100
3	Per fasaden e objekteve	Lekë/m2	30
4	Kontroll i piktimit te objekteve	Lekë/kontroll	2.000
5	Kontroll pas perfundimit te themeleve	Lekë/kontroll	5.000
6	Kontroll pas perfundimit te karabinase	Lekë/kat	2.000
7	Kontroll mbi sistemimin e ambientit rrethues		3.000
8	Akt kontroll i perfundimit te punimeve për leje perdorimi	Lekë/m2	50
9	Azhornim genplanesh per leje ndertimi	Lekë/m2	40
10	Matje e percaktim i zones se vendndodhjes se objektit, azhornim i genplanit	Lekë/dokument	3.000
11	Azhornime per reklama e zenie hapësirash publike	Lekë/dokument	2.000

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës;

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifave është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifën e urbanistikës është Drejtoria e Urbanistikës.

2.4.2 Tarifa të shërbimit veteriner

Në lekë

Nr	Tarifat per therje	Njesia e matjes	Tarifa
1	Per cdo gjedh te therur	Lekë/koke te therur	100
2	Per cdo derr te therur	Lekë/koke te therur	100
3	Per cdo te imet te therur peshku	Lekë/koke te therur	50
4	Per cdo parti peshku te kontrolluar	Lekë/njesi tregtsre	100

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës;

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifën e shërbimit veterinar është Sektori i Inspektoriatit Veteriner .

2.4.3 Tarifa per sherbimin ne fushen e transportit te pasagjereve dhe mallrave, dhenien e lejeve per ushtrim aktiviteti

Kategoritë	Niveli	Vlera në lekëe
Tarifa maksimale për transportin e udhëtarve me taksi në zona urbane nga ora 06:00-21:00	Për distancën deri në 2 km	300 lekë/udhëtar
	Shtese nga nisja, shtesa në lekë nga taksisti	150 lekë/udhëtar
	Tarifa për distancën deri në 14/km	1.600 lekë ose 114.3 lekë/km
	Tarifa për distancën mbi 14 km deri në 30 km	3.400 lekë ose 118/lekë/km
	Tarifa për distancën mbi 30 Km	153 lekë për çdo km
Tarifa maksimale të udhëtimit në zonat jo urbane nga ora 06:00 – 21:00.	Tarifa fillestare deri në 2 km	350 lekë
	Për çdo udhëtar shtesë aplikohet	50% e tarifës fillestare
	Tarifa deri në 14 km	1.350/lekë, ose 96.4 lekë/km
	Tarifa mbi 14 km deri 30 km	2.950 lekë, ose 92/km
	Tarifa mbi 30 km	133 lekë/km.

Për çdo udhëtim në tarifimin e taksimetrit nga drejtoria e kalibrimit vëndoset tarifa fillestare e udhëtimit deri në 2 km e para plus sipas distancës përshkruar më sipër.

Për sherbime të kryera pas ores 21:00 deri në oren 06:00 si dhe në ditet e djela e festa zyrtare çdo tarife udhëtimit t'i shtohet 10% e vlerës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës;

Licensat dhe certifikatat përkatëse, jepen me afat pesë vjecar, subjekteve juridike ose fizike të licensuar si biznes transporti ose si biznes tjetër të cilit i vehet në dispozicion mjete.

Për vjeljen e këtyre tarifave ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, pas rakorimit për shlyerjen e detyrimeve tatimore, me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

2.4.3.1 Tarifat e licencimit të transportit të udhëtarëve

Nr	Tarifat e licencimit të transportit të udhëtarëve	Njësia e matjes	Tarifa
A	Liçense per transport udhetaresh ne linje te rregullt qytetese	Leke/5 vjet	40.000
2	Çertifikate per transport udhetaresh ne linje te rregullt qytetese	Leke/mjet/vit	1.000

3	Liçense per transport udhetaresh ne linje te rregullt rrethqytetese	Leke/5 vjet	20.000
4	Çertifikate per transport udhetaresh ne linje te rregullt rrethqytetese	Leke/mjet/vit	1.500
5	Liçense per transport udhetaresh ne linje te rregullt nderqytetese brenda qarkut	Leke/5 vjet	75.000
6	Çertifikate per transport udhetaresh ne linje te rregullt nderqytetese brenda qarkut	Leke/mjet/vit	1.500
7	Liçense per transport udhetaresh ne linje te rregullt nderqytetese ndermjet qarqeve	Leke/5 vjet	75.000
8	Çertifikate per transport udhetaresh ne linje te rregullt nderqytetese ndermjet qarqeve	Leke/mjet/vit	1.500
9	Liçense per agjensi transporti udhetaresh dhe taksi brenda vendit	Leke/5 vjet	15.000
10	Liçense per agjensi nderkombetare udhetaresh	Leke/5 vjet	40.000
11	Liçense per transport udhetaresh me taksi	Leke/mjet/5 vjet	20.000
12	Dhënie autorizimi per transport nderqytetas	Lekë/mjet	2.000
B	Tarifat e Liçensimit te Transportit te mallrave		
1	Liçense per transport mallrash per te trete dhe me qera brenda vendit	Leke/5 vjet	40.000
2	Çertifikate per transport mallrash per te trete dhe me qera brenda vendit	Leke	100
3	Çertifikate per transport mallrash per vehte brenda vendit	Leke	100
4	Çertifikate per transport mallrash & udhëtarë	Leke	3.000

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës;

Per vjeljen e ketyre tarifave ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, pas rakorimit për shlyerjen e detyrimeve tatimore, me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

2.4.3.2 Tarifa për autorizim për shitje karburanti

Në lekë

Nr	Tarifa për autorizim për shitje karburanti	Njesia e matjes	Tarifa
	Autorizim shitje karburanti me pakice	Lekë/autorizim	50.000

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës;

Per leshimin e autorizimit të pagesës së kesaj tarife ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike (sektori i transportit), pas rakordimeve për shlyerjen e detyrimeve tatimore, me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

2.4.4 Tarifa për shërbime në institucionet e varësisë

Nr	Tarifat sipas kategorive	Njesia e matjes	Tarifa
A	Përdorimi i ambjenteve në Pallatin e Kulturës		
1	Salla e leksioneve	Lekë/orë përdorimi	3.000
2	Salla e madhe e shfaqjeve	Lekë/orë përdorimi	10.000
3	Per shfaqjet të organizuara nga institucioni për publikun	Lekë/person	Falas
4	Përdorimi i sallave për zhvillime provash	Lekë/orë përdorimi	falas
5	Salla e Galerisë së arteve për ekspozita	Lekë/ditë përdorimi	3000
6	Salla e Galerisë së arteve, Për piktorët e rinj e talentet e reja	Lekë/ditë përdorimi	Falas
B	Bibloteka Publike e Qytetit		
1	Holli në katin e dytë	Lekë/ditë përdorimi	3.000
2	Hapje kartele lexuesi të rregullt	Lekë/kartelë	50
3	Hapje kartele lexuesi per femijet		Falas
C	Muzeu & Memoriali		
1	Për të rritur	Lekë/biletë	100
2	Për fëmijët	Lekë/biletë	50
3	Per grupe mbi 30 veta	Lekë/biletë	30
D	Klubi Sportiv Besëlidhja		

Germa D Klubi Sportiv Besëlidhja, shfuqizohet

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifave;

Per vjeljen e kesaj tarife ngarkohet strukturat/institucionet përgjegjëse që i kanë në administrim.

2.4.5 Tarife shërbimi per tregjet publike

Në lekë

Nr	Tarifat e tregut sipas kategorive	Njesia e matjes	Tarifa
1	Shites artikuj industrial	Lekë/muaj	1.000
2	Shites artikuj ushqimore	Lekë/ muaj	1.500
3	Shites artikuj bulmeti e mish	Lekë/ muaj	2.000
4	Shites ditore	lekë/m ² /në ditë	100

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifave;

Ngarkohet për vjeljen e detyrimeve, agjenti tatimor që ndjek shfrytëzimin e tregut publik, sipas kontrates me Bashkinë Lezhe, në rakordim me drejtorinë e Taksave dhe tarifave Vendore .

2.4.6.Të ardhura nga qerata e objekteve

Për dhënien me qera të objekteve pronë e Bashkisë në zbatim të VKM nr.1712, datë 24.12.2008, çmimi të jetë 350/lekë/m².

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifave;

Ngarkohet Drejtoria Juridike për lidhjen e kontrates me subjektin që merr me qera objektin. Për vjeljen e kësaj tarife ngarkohet Drejtoria e Financës përgjegjëse që i kanë në administrim

NENI 3

Kapitulli III Gjobat

Nr	Emertimi	Njesia	Niveli
A	Gjopa për demtimet dhe nderhyrjet në infrastrukturen rrugore		
	1.Bllokim rrugë dhe trotuari	Leke/ml	20,000
	2.Demtim,çarje	Leke/m ²	15,000
	3.Ndotje trotuari nga demtimi	Leke/m ²	15,000
	4.Vjedhje zgare	Leke/cope	15,000
	5.Vjedhje pusete	Leke/cope	20,000
B	Gjopa për demtimet dhe nderhyrjet në rrjetin elektrik rrugor		
	1. Demtim i ndriçuesve	Leke/cope	20,000
	2.Perdorim i shtyllave si suport për montimin e reklamave,kapjen e kabllave	Leke/cope	20,000
	3.Nderhyrjet në kuadrin e komandimit	Leke/cope	20,000
C	Gjopa për demtimet dhe nderhyrjet në rrjetin e ujësjes		
	1.Lidhje të pamiratuara në tubacion	Leke/cope	20,000
	2.Demtim i pusetave	Leke/cope	20,000
	3.Demtim i tubacioneve nga punimet që kryhen me ose pa leje.	Leke/cope	20,000
D	Gjopa për demtimet dhe nderhyrjet në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza		

	1.Lidhje te pamiratuara ne tubacion	Leke/cope	20,000
	2.demtim i pusetave	Leke/cope	20,000
	3.Demtim i tubacioneve nga punimet qe kryhen me ose pa leje.	Leke/cope	20,000
E	Gjoha per demtim fasade	Leke/m2	5,000
F	Gjoha per demtimet dhe nderhyrjet ne hapësirat e gjelberta dhe ato publike		
	1.Demtim,prerje pemesh	Leke/cope	20,000
	2.Zenie hapësire te gjelberta pa leje	Leke/m2	15,000
	3.Vendosje posterash pa leje nga kompanite e ndryshme	Leke/rast	20,000
	4.Vendosje tabelash,pankartash,banderolash pa leje	Leke/cope	5,000
G	Gjobe per hedhje te materialeve inerte ne vende te pamiratuara	Leke/m3	3,000
H	Gjobe per mospajisje me leje per tregtim apo sherbim jashte siperfaqes se njesive	Leke/rast	20,000

Strukturat përgjegjëse për vendosjen dhe vjeljen e gjobave;

Per vendosjen dhe vjeljen e gjobës, pas evidentimit te kundravajtjes, ngarkohet Policia e Bashkisë.

NENI 4

Kapitulli IV Anekse

Aneksi Nr1: Tarifa e Shërbimeve Publike (Pastrimit dhe largimit te mbeturinave, gjelbërimit, ndriçimit dhe dekorit)

NR	KATEGORITE	NIVELI I TARIFES	
		BV	BM
		Leke/vit	Leke/vit
I	FAMILJARET (per familje)	2200	
II	BIZNESI		
II.1	SHITJE ME PAKICË		
	Mish	7000	37000
	Peshk	10000	45000
	Bulmet,Fruta, perime, ushqimore e artikuj te tjere te ngjashme me to.	10000	37.000
	Artikujt industrialë (veshje, parfumeri, argjendari, etj të ngjashme me to).	5000	27.000
	Bar kafe	5000	32.000
	Restorant, fast food etj te ngjashme me to	15000	37.000
	Pub, diskoteka etj te njashme	10000	32.000

	Kafe internet, lojëra fati, qendra interneti	5000	32.000
	Njesi tregtimi lendesh djegese, hidrokarbure, karburante etj te ngjashme me to.	5000	30000
	Shitje produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to	5000	27.000
	Etj te ngjashme me to		27.000
II.2	SHITJE ME SHUMICË		
	Magazina, dyqane, etj te cilat realizojnë shitje me shumice	15000	37000
II.3	NJESI PRODHIMI		
	Perpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie letre, kartoni, plasmasi etj te ngjashme me to	10000	47.000
	Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gelqereje, nyje inerte etj, te ngjashme me to	15000	47.000
	Prodhime ushqimore, buke, embelsirash, mishi, peshku, bulmeti, pijesh etj te ngjashme me to.	10000	47.000
	Perpunim mish, peshk etj te ngjashme me to	10000	57000
	Prodhim konfeksione, etj te ngjashme me to.	10000	47.000
	Prodhim, perpunim vajrash, nafte , gazi e nenprodukte etj te ngjashme me to.	10000	47.000
	Impiante, territore per therrjen e kafshëve etj te ngjashme me to.	25000	57.000
	Shtypshkronja etj te ngjashme me to.	15000	47.000
	Impiante, linja për prodhim dhe përpunim e produkteve ushqimore ose të tjera.	10000	42.000
	Prodhim perpunim produkte farmaceutike etj te ngjashme me to.	5000	42.000
II.4	SUBJEKTE NDERTIMI		
	Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, objekte banimi, shërbimi, të përbëra etj të ngjashme me to. ,	20000	100.000
	Rikonstrukcione te pjeseshme	10000	60.000
	Subjekte Ndertuese per selinë administrative	5000	30.000
II.5	NJESI SHERBIMI		
	Riparimi i artikujve elektro-shtepiake, radio televizore, frigorifere, lavatrice, manjetofon, paisje fonie e te tjera te ngjashme me to.	5000	42.000

	Sherbime agjensi kembimi valute, agjensi turizmi, agjensi sigurimesh etj te ngjashme me to	5000	17000
	Sherbime fotokopimit, sallon bukurie, autoservise, kurse per makina (autoshkolla) per traktore, per kompjuter e per parukeri, agjensi doganore, sherbime kredi dhenie, sherbime bankare, sherbimet per konviktet. pikat e sherbimit te makinave (autoservis), parkimi i makinave, agjenci transporti, lvanterite, pastrimi kimik, sherbime te rojeve civile, sallat e lojrave te ndryshme (gjimnastike, aerobie, cirqe, kende lojrash per femije, ping pong, etj.) e te tjera sherbime te ngjashme me sherbimet e lartepmendura.	5000	42.000
	Shtëpi botuese, biblioteka	5000	42.000
	Hotele, motele (leke/ dhome ne vit)	500	1000
	Njësi shërbimi marangoz, rrobaqepës, këpucar, floktore, orëndreqës etj	5000	42.000
	Komplekse sportive, palestra, fitnes, pishina, qendra e institute kerkimore-shkencore, salla koncerte-mbledhje e videoteka	10000	37.000
	Lojra me kompjuter, lojra fëmijësh të hapura dhe të mbyllura	5000	42.000
	Njësi të tjera (që nuk përfshihen në kategoritë dhe nënkategoritë si më lart)	5000	42.000
II.6	SHOQATA, FONDACIONE, ORGANIZATA JOQEVERITAR .		10000
II.7	ENTE TË NDRYSHME SHTETËRORE LEKE/M2/VIT		100
II.8	PROFESIONE TE LIRA		
	Avokatet, noter, mjek, mjeku-laborant, stomatologu, ekonomisti kontabël te miratuar, eksperti kontabël te autorizuar, mësuesit, veterinerët, agronomit, botuesit, inxhinier, arkitekti, projektuesi, e te tjera profesione te lira te cilat ushtrohen ne njësi fikse apo ne ambiente te ndryshme e të tjerë të ngjashëm me to.	5000	17.000
	Galeritë e artit te piktoreve, skulptoreve dhe artisteve te tjerë qe prodhojnë dhe tregtojnë objekte artistike	5000	12.000

	Institucionet jopublike te edukimit (shkollat, kopshtet apo çerdhet), , shërbimet ne klinikat e specialiteteve te ndryshme mjekësore, shërbimet ne laboratorë diagnostifikimi	5000	17.000
II.9	AMBULANT		
	Subjekte qe nuk kane një vendndodhje fikse, taksi, tregtia ambulante ne tregje publike dhe private.	1000	
II.10	TRANSPORT		
	Transport pasagjerësh	2000	15.000
	Automjet deri 5 vende		
	Automjet 6-9 vende		
	Automjet 10-25 vende		
	Automjet 26-42 vende		
	Automjet mbi 42 vende		
	Transport Mallrash	3000	17.000
	Automjet deri 2 tonë		
	Automjet 2-5 tonë		
	Automjet 5-10 tonë		
	Automjet 10-16 tonë		
	Automjet mbi 16 tonë		
	Transport Ujor	5000	22.000
	Transport detar brenda vendit		
	Transport në liqene brenda vendit		
	Varka për shetitje		
II.11	TË TJERA	5000	10000
1	Pensionistët (te vetmuar, me persona ne ngarkim pa pune)		0
2	Veteranët		0
3	Invalidët e punës dhe të luftës		0
4	Përfituesit e ndihmës ekonomike		0
5	Të verbërit		0
6	Të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik		0
7	Familet e deshmoreve		0

NENI 5

KAPITULLI V Dispozita te veçanta

5.1. Kur e miraton Këshilli i Bashkisë mbledhjen e një takse apo tarife vendore me agjent fiskal, të propozuar nga Kryetari i Bashkise, agjenti fiskal të shpërblehet në përqindje mbi vlerën e arkëtuar, në masën e përcaktuar me Vendim të Keshillit Bashkise

- 5.2. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Lezhë, nr.97, datë 12.12.2011, i ndrshuar me VKB nr.55 date 24.12.2012 shfuqizohet.

NENI 6

Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë

NENI 7

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI
AGOSTIN MARKU**

Shenim : Me shkronja te kuqe pasyrohen ndryshimet e ndodhura ne paketen fiskale me VBK nr.2 date 15.01.2015